

Procesverbal

Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa , e mbajtur më datë: 06.02.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e parë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së për vitin 2025! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë, ku i kemi tri pika të rendit të ditës. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës, urdhëroni! Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për miratimin e këtij procesverbali? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Vazhdojmë me pikën e dytë: Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e parë të rregullt. Atëherë, fillojmë te pika e dytë: Anulimi i Vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ZK Dragash P-70604014-00099-1, me pronën e përbashkët të z.Amir Ahmet Jaminit, z.Asat Ahmet Jaminin, Rejan Omer Jaminin dhe Nerkez Omer Jaminin, pronën me numër të parcelës P-70604014-00827-2 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë?

Bexhet Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes dhe ju uroj një fillim të mbarë të këtij viti, me seancën e parë të KPF-së. Ju e dini që çdo vendim që vjen i paligjshëm nga ana e ministrive dhe që është i miratuar nga Asambleja Komunale, në seancë e parë të radhës duhet të anulohet. Kështu që, vendimin që e kemi marrë në mbledhjen e fundit të Asamblesë Komunale, për këmbimin e pronës, ka qenë çështja e ndërtimit të një rruge dhe ndërtimit të një kanalizimi. Edhe pse kjo rrugë ekziston qe ndoshta 30 vjet, por megjithatë, kur kemi fillue me e bo kubëzimin, ka dalë që një pjesë e saj është pronë private. Kështu që, Asambleja Komunale ka prurë vendim që të bëhet këmbimi i kësaj prone, t'i jepet po aq pronë, në një vend kudo tjetër ku ka pronë komunale. Asambleja këtë e ka bo, mirëpo ministria gjegjëse ka kërkuar një seri dokumentacionesh, edhe këto ne nuk mund t'i bëjmë shumë shpejt. Kështu që, për mos me kaluar afati njëmuor, ne do ta bëjmë anulimin, pastaj, ndërkohë, do ta përgatitim të gjithë dokumentacionin që e kanë lyp, do ta marrim një vendim tjetër dhe do ta kryejmë këtë punë.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Rreth kësaj pike, kryetar, në seancën e fundit të kam tregue që është problemi tjetërkund. Tendrin e keni qit me e bo kubëzimin edhe është i ndërprerë tenderi, e dish shumë mirë. Problemi është problem gjyqësor, pak ma nalt. Ta kam thënë që problemi nuk është këtu se ka rrrugë. Është mirë me e marrë atë pjesën, po ka mund edhe pa atë pjesën me u shtrua asfalti edhe kuvëzimi, çka ke me bo aty. Problemi është pak më i madh. Edhe, kryesuesja në seancën e fundit na ka thënë që nuk po i lexoni rekomandimet. Qat rekomandimin e Ministrisë, a ka mundësi na delegatët me e ditë, a veç me ju besue fjalëve të juaja. Se rekomandimin na nuk e kemi. Kryesuesja në seancën e fundit na ka thënë mu edhe Uranit se nuk po i lexoni. Me e ditë na qetash e me ju besue juve, a jo. Edhe qetu kur e ke qit, herën e parë e ke bo interes publik. Të kam thënë edhe atë bre kryetar, nuk është shumë interes publik kjo rrugë. Interesi më i madh publik është te udha e Libevishtit e deri te Biblioteka. Ti i e dish problemin, ai është problem privat, problem gjyqësor, ju po merrni me e asfaltue edhe me e bo shpronësimin. Bone zgjidhjen, ti më ke thënë mu që deri në fund të mandatit do ta kryjmë problemin me gjyqin. Kjo punë s'është urgjente. Deri në fund të mandatit tënd – se nuk të ka mbet edhe shumë – kryeje problemin gjyqësor, edhe masnej e qesim në tender edhe e qesim me e shpronësue. Po më vjen se pak po nguteni, po doni me bo mirë, po s'un po ia qëlloni kurrqysh.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë e qesim në votim. Kush është këtij anulimi të Vendimit? A ka kundër? A ka abstenim? Me tri vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë kalojmë te pika e tretë: Raporti Financiar Tetor-Dhjetor 2024, tremujori i katërt i vitit 2024. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? A ka abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Raporti Vjetor Financiar për vitin 2024. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e qesim edhe këtë në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë te pika e pestë: Raporti i Punës së Kuvendit për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim? Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Raporti i Punës së KKS-së për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Atëherë, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës së KPF-së, pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Te pika eventuale deshta me u kyç – u bëmë shumë monotonë na të dy, me ndriçimin e fshatit Rrenc. Atë ditë që të fola unë, kryetar, për ndriçimin, të kam thënë që me 20 mijë euro nuk bëhet, e ke bo me dy vite. 20 mijë i ke dhënë, edhe 10 mijë për buxhetin e 2025-tës nuk e pashë, me siguri prej të hyrave vetanake ke me i dhënë edhe 9 mijë euro. Ai është problem i yti. Por, u bo një atmosferë

e keqe në seancën e fundit këtu, atë ditë, një dhunë ndaj minoritetit, e ndërmjet vete diçka do, seanca s' shkoj mirë edhe na do e lëshum seancën e dolëm. Por kur shkova në shtëpi e dëgjova fjalimin tënd, përgjigjen që ma dhaje mu. PDK-ja – se më thaje ai djali, ai djali, qeshtu kishe bo me dorë kah unë, thaje ai djali që katër a pesë vite po fol për atë. Na e kemi bo projektin, po e kemi bo na projektin, unë e kam lyp projektin. Po edhe ti e lypish projektin, po projektin nuk e bojsh vetë ti. E bëjnë punëtorët tu poshtë, a po? Edhe qat projektin kur e keni pa që është gabim, kur e keni pa që me tendencë unë i kam bo dy rrugë kryesore për vota – shumë fjalim i ulët kish qenë, mos ta lëshoj këtu – pse ju nuk e përmirësuar para se me e qit në tender. Për një grusht vota, nha 10 vota mundish me i kap qaty, e dini që ma shumë s' un mundni në katund, jo ju po kërkush s' un më mundni. Përgjigjja jote ka qenë shumë e dobët për mu atë ditë. Mu më ke çudit me qat fjalor ndaj meje. Artani i paska bo për inate personale të votuesve të partive tjera, unë s' i paskam çue në dy rrugë. Njëra rrugë, që nuk është bo, që është bo gabim, se punëtorët që kanë punue me ne dhe që punojnë me ty, prej këtu i bëjnë koordinatat atje. Është gabuar rruga. Njëra rrugë – që më ke akuzue mu – është për te varrezat ku është baba jem aty. Në qoftë se unë shkoj kundër familjes time edhe kundër babës tem, kjo është e ulët për ty. Edhe njëra rrugë është rrugë kryesore. E ke nxit atë kandidatin e juaj që e keni kryetar të katundit, të LDK-së, çka e keni atë Shabanin, e keni nxit atë – unë e di edhe kush e ka bo, unë e kam bisedën, bisedën e postoj. Tre bandera Artani s' t' i ka pru ty për inat, se je votues i LDK-së. Ajo është e ulët. Ajo është rrugë kryesore, ku ka ec baba yt edhe i jemi, ku ke ec edhe ti. Është rrugë kryesore edhe në rrugë kryesore s' ka bre vota. Ju u mytët nëpër lagje, nëpër kurtina t' u shti kubëzime, e s' po folim na. Na nuk i kemi bo për vota. Ajo rrugë është rrugë Rrenc-Kapre, është rrugë kryesore, s' paskna mbrri dy bandera me i çue edhe kryetari thotë për çështje politike, partiake. Është e ulët, shumë e ulët, kryetar. Krejta boni, këtë mos e bën. Edhe rruga tjetër, të thashë edhe një herë, shkon te varrezat, ku janë familjarët e mi. Në qoftë se unë s' kam desht vetes time me i bo ndriçim edhe me e ndriçue babën tem te varri, marrre është kryetar, duhet me kërkue falje. E dyta: shefat e ri që i ke vu në QKMF, po më vjen mirë. Qat shefin që e ke vu, tri të xhumaja punë nuk i ka, hala s' i ngjeh punëtorët – zv/drejtoreshën që e ke vu, hala s' i ngjeh punëtorët, tri të xhumaja punë i ka ajo. Edhe ma ke kujtue ni send, punën e Nasradinit, kur kish ardhë me një udhëkryq, kish thonë kah po shkojmë, kish thonë kah kemi bo mirë s' po shkojmë se na hakmerren, po shkojmë qane kah kemi bo keq. Mos po të kujtohet para luftës, në qat zyrë sa ke qenë i maltretuar – mos të hi shumë – prej familjarëve të qasaj që e ke pru aty. Dy-tri orë ke prit te dera me hi me e marrë një përgjigje. E dish shumë mirë, të vjen ma bonë çka po due me të thënë. Të hënë ta them në seancë, se s' po kam qef pa u konë këtu edhe vetë. Tjetra: TV Opoja, a bën me e ditë, a paguhet prej Komunës a jo? Unë e kam një revoltë të madhe edhe kam me kërkue që nesër mos me qenë prezent TV Opoja këtu, për arsye se në seancën e fundit, në pjesën e parë ka qenë Live ka incizue, mas pauzës që e ka incizue pjesën e dytë nuk e ka në TV Opoja. Unë nuk e di a është bo dhunë ndaj jush, unë po due me e

pa veten time çka kam folë, në TV Opoja nuk është pjesa e dytë e seancës së 18 dhjetorit. Live ka qenë, pjesa e parë është edhe është ndërpre. Jo kryetar, pjesa e dytë nuk është hiç, e keni fshi ju me tendencë, me qëllim e keni fshi. Edhe në TV Bambus a qysh i thonë asaj, që paguhen, edhe aty kam hy me kqyrë, nuk është. Edhe Radio Sharri qato pjesët kur u konë ajo afëra mes vete ju këtu, janë të prera. A qaq po bëni presion edhe ndaj mediave? Po unë kam shkue në shpi, me e pi një kafe edhe me ju kqyr live. Në TV Opoja pjesa e dytë e seancës nuk është. Kurrë bre kryetar qeso dhunë nuk kanë pas mediat, edhe në media mo qaq po hyni, po nejse. Edhe, në seancën e fundit mu më erdh pak keq, rreth votimit të Statutit të QKMF-së, kur katër ose pesë herë është votue, deri e ndreqët ju qysh deshtët. Katër-pesë herë është qit në rend dite – kjo vlen edhe për kryesuesen – edhe më erdh çudi zv/kryesuesit me ia ndalë fjalën me zor. Unë s’po di këta tjerit pse s’po reagojnë. Ne në PDK, 14 vjet minoriteti u konë me ne, pasha Zotin si pula në grun kanë qenë, janë knaq. Me ia ndalë zv/kryesuesit dy-tri herë, s’ta jap fjalën, po më vjen shumë e pakapshme. Unë në Kuvend jam që tri mandate, nuk ka ndodhë kjo që ka nis me ndodhë kohët e fundit. Me u ndalë zv/kryesuesi i Kuvendit me folë, me ia ndalë mikrofonin, s’ka ndodhë kurrë. Në Radio Sharr, qato pjesët ku janë konë kaqikat e çkaqikat i kanë ndërpre, në TV Opojë pjesa e dytë nuk është hiç, domethënë është e leçitme prej Facebook-it, në Bambus nuk është hiç. Nuk e di, unë po due me e ditë pse dhe në qoftë se paguhet TV Opoja. Unë nesër kam frikë me m’incizue ai, se s’kam ku me e pa veten, bon vaki munden me ndodhë edhe ndonjë skandal tjetër, ju i fshihni ato. Domethënë, kam nis mos me u ndie i sigurt edhe në Kuvend unë. Bash ku është fjala e lirë, ku është fjala demokratike këtu, unë kam nis me u ndie pak në tut, në frikë, se po bojkot ju edhe këto manipulime me i fshi krejt. Seanca krejt osht e fshime. Hini kqyrne, pjesa e dytë mas pauzës nuk është hiç në TV Opojë. Kam desht me i thirrë, me iu thënë po due me e pa fjalimin tem, thashë mos p’e marrin kërcënim, se ky i PDK-së, këta janë të qqi, ktë të vrasin, këta të presin, edhe u tuta vallahe, thashë hajt nesër t’jau boj do pyetje këtu juve.

Uran Halimi: Përshëndetje, të nderum pjesëmarrës të këtij Komiteti! Realisht, në pjesën e dytë të seancës së kalume unë kam mungue për arsye personale, edhe kam pas dëshirë me e përcjellë seancën, s’kam mund me e gjet të kompletme. Unë mendoj që kjo është mostransparencë edhe jodemokratike, mospublikimki ose fshirja e incizimeve të seancës. Ne si Grup i LVV-së e dënojmë këtë akt. Përderisa seanca është publike, nuk e di pse duhet me u fshi ajo pjesë. Janë mediat ato të cilat na i paguajmë me buxhet të kësaj Komune. Është mirë që me qenë shumë transparente, sidomos mediat të cilat ne i kemi të vetmet mjete të informimit. Kështu që, znj.kryesuese, me ndikue në këtë pjesë është mirë, se i kontribuojs edhe demokracisë në Komunën tonë. Ka pas tendenca vazhdimisht që mos me u publikue disa pjesë të seancave, nuk e di a është me qëllim a pa qëllim, por mu shpeshherë më është dashtë bon vaki edhe me i kontaktue pronarët e mediave, edhe me e lyp publikimin e seancave. Edhe kur kam qenë unë kryesues, edhe tash. Për hatër të transparencës edhe demokracisë, ju kisha lut që seanca, qyshdo që

është, le të publikohet edhe le të jetë si dëshmi se çka është bo në Kuvend. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Kryesuese, më fal dhe faleminderit që ma dha fjalën! Unë kërkoj nga kryetari, edhe nga kryesuesja, edhe nga krejt partitë politike, që të bëhet presion në TV Opoja edhe në këto tjerat, me i rikthye incizimet edhe me qenë publike. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, pasi m'u përmend emri, deshta të nisi një herë me Artanin. Artani po thotë që ka mesazhe. Kur thotë që ka mesazhe, edhe ky duhet me u bo transparent, me thënë që Shabanit i janë çue mesazhet, duhet me qenë ato në opinion. Masi po lyp transparencë. Edhe unë jam shumë e interesuar që kush i ka çue mesazh, se aty po prekem unë, se unë jam asambleiste nga Rrenci. Ndoshta munden opiniononi me thënë që Arijeta e ka kërcënue se është e qasaj partisë. Unë të kisha lut edhe ty, Artan, që të hënën, para mediave, ti me e kallxue qat mesazhin e Shaban Skerajt. E dyta: për te zv/kryesuesi, ti Artan, bashkë me do asambleistë të tjerë thoni që Arijeta nuk di me e zbatue Rregulloren. Me Rregullore, Artan, ti edhe unë shumë vjet jemi këtu, për një pikë të rendit të ditës veç një herë ke të drejtë. Z.Munir e ka pas të drejtën me e marrë fjalën edhe ka folë mbi pesë minuta. Të dytën herë nuk iu përmend emri. Unë nuk mundi me e shkelë Rregulloren. A në qoftë se duesh, kur të vish ti këtu, e shkelish ti. Sa për mediat, mundesh të tri mediat me i thirrë, në qoftë se unë iu kam bërë presion. Absolut, ndoshta kam qenë edhe më shumë që kam dashtë me i pa ato, por unë presion kërkujt s'i kam bo. Që keni dashtë ju me m'bo presion, tjetër gjë është. Sa për mediat, unë, në seancën e parë, nuk më është bërë Live seanca solemne, mundeni me i pyet krejt këta. Unë kam reague, kam mbet në vesh të shurdhër edhe më nuk jam marrë me mediat. Kështu që, Artan, të jesh i bindur se unë nuk jam. E dyta që due me thënë për seancë e fundit: Ty Artan, veç një kamerë me ta vu përmbi krye. Unë s'po shoh, po e pranoj që s'po shoh, ndoshta prej ngarkesës, por zyrtari me thotë po e lyp ai e po e lyp ky. Ti je Artan i fundit që e lypish fjalën masi ta marrin krejt në foltore. Unë pyes a ka dikush që do me e marrë fjalën – jo – edhe unë them hajde po e qesim në votim, ti thuesh prit prit prit se unë e kam. A e dish që shumë herë prej pikës së rendit të ditës dilni në personale. 18 vjet edhe unë jam asambleiste, asnjëherë kërkund s'e kam ba. Mundish me shkollë ose diçka tjetër. Kapesh në personale me atë, kapesh në personale me këtë. Tash ia ke nis edhe me mu. Kapu, se edhe tetë muaj i ke me mu. Por, ta dish se ti më ke votue mu këtu, edhe s'është mirë qashtu mu me ma bo para mediave. Le të dalë ndonjë që nuk ia kam dhënë fjalën, përveç se atëherë kur s'ka pas të drejtë. Unë kur t'ia jap zv/kryesuesit, çka ke ti që mos me ta dhënë të dytën herë. Në qoftë se edhe ty të dytën herë, edhe atij të dytën herë, unë deri në ora 5 me e zgjat për një pikë të rendit të ditës a? Ne kemi me debatue, por i debatojmë krejt pikat me rend. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryesues, për publikimin e mesazhit, menjëherë unë ta jap, kur ta ktheni incizimin e llajvit të TV Opojës. Kryesuesja e Kuvendit edhe Kuvendi është organi më i lartë i Kuvendit Komunal.

Në qoftë se ti nuk mundish me e kthye, çka mundim me bo ne të tjerët. Në qoftë se ty s'të kanë lënë edhe s'ta kanë bo llajvin atë ditë që e ke marrë postin – po, se PDK të ka votue ma shumë LDK, nuk të kanë votue asambleistët e tu, edhe ka qenë edhe presion ndaj teje. A po e shohish sa mirë e pranove, këtu ka presion mediatik. Aty ku nuk i konvenon pushtetit, nuk bëhen incizimet. Sa që e kam personale me ty, nuk e kam personale me ty absolut. Mundesh me e marrë ti qysh të duesh, unë të kam votue i pari, e kam qit publike, kam me e votue Arijetën. Prapë kur të vjen puna Arijeta edhe një asambleist tjetër i LDK-së, prapë unë kam me ta dhënë votën, në qoftë se jam unë këtu, në qoftë se duhet vota jeme, publikisht them se unë prapë të votoj ty, për shumë sende. Vijsh nga Rrenci, jemi kolegë të një profesioni, jemi edhe kemi qenë familjarë, edhe familjarisht jam me ju, edhe problemi më i vogël është. 25 me qenë të LDK-së, veton me qenë ti, unë jam që kam me të mbështet. Që kam personale me ty, jo! Që është presioni ndaj ndriçimit në fshatin Rrenc, nga vartësit e kryetarit, është shumë e vërtetë. Është shumë palidhje me e diskutue këtu. Mu tash më kanë thirrë në telefon, më kanë kontaktue live, që duesh ti me e bo mediatike, e boj edhe një emision me ata qytetarët e fshatit Rrenc, na të dy. Që duesh me e diskutue edhe me e pa që ka pas presion, edhe unë e ti i thirrim ata qytetarë, që Artan Loshaj në fshatin Rrenc ia bën dikuj për inat. Unë mundem me ia bo për inate politike dikuj, nuk e kam në natyrën teme, po qetu te ndriçimi nuk ka pas arsye për me u diskutue. Qeky djali që tri-katër vjet ka thënë qite, qite!. Unë kam me ia lëshue incizimin të hënën kryetarit këtu, ky është fjalim i ulët i kryetarit më thënë qeky djali. Unë s'jam qeky djali, kryetar, unë jam asambleist për kryetarin. Unë kryetarin nashta s'e due hiç, po i them zotni kryetar, zotni doktor. Ky duhet pak fjalorin me e ndryshue. Dy rrugët që Artani e paska bo për inat të votuesve, duhet me kërkue falje kryetari. Njëra rrugë është rrugë kryesore, kam thënë edhe atë ditë, Dragash-Shajne-Rrenc-Kapre-Opojë, është rruga për te varrezat e poshtme ku i kam familjarët e mi. Në qoftë se unë jam kundër familjarëve edhe kundër vetvetes shkoj, atëherë unë s'jam normal. Rruga e dytë – ti vijsh nga fshati Rrenc – nuk është që ka hi nëpër lagje, 59 mijë euro tash që i keni për Rrenc, keni me i shti nëpër shpia. Hallall ju koftë, ju kam thënë shtini se ata janë bashkëfshatarë të mi, merrni votat, fitoni votat, se nuk e kam për vota. Me diamant me e shtrue Rrencin, nuk më pengon, veç rrugën kryesore unë e paskam ndërprerë, dy bandera, po veç LDK e bën këtë edhe vartësit e kryetarit. Në PDK nuk ka pas këso fjalime, ti ke qenë tri mandate me ne. Kjo është shumë e ulët, edhe duhet me kërkue falje e jo me ik kryetari. Edhe topin e qet te na të dy. Kurgjo s'kam personale absolut me ty. Po, për te kryesuesi, për te votimi, qe pesë herë, pesë herë që po bën presion kryetari me vartësit e vet ndaj minoritetit, mu po më vjen çudi këta morë pse s'po reagojnë! Pesë herë, me minuta t'i kam ngjeh: minuta e 48 e 40 sekonda votimi i parë; votimi i dytë minutën e 50-të; votimi i tretë në minutën e 50-të e 30 sekonda; votimi i katërt në 51 minuta; votimi i pestë deri e rehatuat mirë. I keni bo dhunë minoritetit. Edhe propozimi i Munirit që të votojnë të gjashtit – incizimet kam me t'i lëshue të hënën, se po më shtini shumë – edhe propozimi me mbet i kryetarit edhe i atij mësuesit Behar, të

famshmit, me mbet në fuqi, dy herë votuesit, asambleistët e minoritetit votojnë, edhe për ukin edhe për arushën. Kurrë more s'ka ndodhë në PDK kështu. Qe ku janë kandidatët e minoriteteve. Kjo është dhunë, dhunë jeni duke bo edhe nëpër zyrët e minoriteteve, i keni shti me dhënë dorëheqje, kanë ra në depresion të madh. Mos të hyjmë shumë, do të hyjmë të hënën, kismet, në eventuale.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Artan, prapë te mediat po them. Kur nuk u mbajt seanca live, që u zgjedhë kryesuesi, pse nuk u bo aq zhurmë, me u nque ju krejt Asambleja, po veç unë e bëra këtu skandal. Askush nuk u mor me mu. Pse nuk u bo live, a mundeni edhe ju mu me m'kallxue. Se ju po mendoni se unë edhe i kam kap mediat. A mundeni edhe ju mu me m'tregue që seanca solemne, e para, nuk ka qenë live. Pse nuk e ngrtiet atë çështje? Për çfarë arsye? Edhe ju duhet me e ditë, se mu as live nuk më është bo kur u bona kryesuese, por as live seanca e parë. Ku është problemi? E mos më thuaj mu që ti je organi më i lartë. Se unë Radio Sharrin kam dashtë me e qit përjashta – qe kryetari është këtu – kam thënë ai s'guxon mu me ma incizue më seancën. A ka qenë kështu, Adem? Edhe ti ke marrë pjesë, kërkush nuk keni bo zhurmë, veç vetëm unë s'mundi me luftue. Unë kur kam dashtë, ju s'keni dashtë. Tash ju doni, edhe unë ta shoh a due, a s'due. Jo, se unë kam qenë në gjendje shumë të keqe, kur mu dy a tri seanca nuk më janë qit live, edhe hala live nuk është duke më qit, përveç Televizionit Opoja.

Munir Jonuzi: Pershendetje te gjithëve. Meqenëse u përmenda, dëshiroj të jap disa shpjegime lidhur me ngjarjet në kuvendin e kaluar. Ne të gjithë i referohemi Rregullores së Punës, më vjen mirë për këtë, por duhet t'i respektojmë ato rregullore. Çfarë thotë rregullorja, thot që diskutimi zgjat 10 minuta, përveç raportuesit dhe kryetarit. E përdora këtë të drejtë, fola për 10 minuta, kur erdhi koha e votimit, vura re se delegatët e komunitetit joshumicë ishin pro propozimit tim. Desha të tërhiqja vëmendjen e kryesuesës për atë çështje, për majorizimin, pasi ajo nuk di boshnjakisht, unë nuk di shqip, nuk arritëm të merremivesh dhe doja të përdor një nen tjetër nga rregullorja e Kuvendit që thotë: Shpjegimet apo përgjigjet e mundshme nuk mund të zgjasin më shumë se 2 minuta. Unë u përpoqa të shpjegoj nga kjo foltore se për çfarë bëhet fjalë. Kjo ishte e gjitha sipas rregullave, asgjë e pazakontë. Meqenëse kryesuesja i referohet Rregullores së Punës, duhet ta keni të qartë se ky kuvend ka përfunduar pa kuorum. Delegatët e PDK-së u larguan duke lënë 5 delegatë në kuvend dhe kuvendi zgjati edhe 1 orë. Pse zonje kryesuese nuk e ndërpretë mbledhjen? Ky është obligimi juaj, nëse nuk ka kuorum atëherë kuvendi mbyllet. Këtë e kemi bërë disa herë gjatë vitit 2024. Pashë inxhizimin dhe pashë sa njerëz ishin të pranishëm. Nuk e di nëse ka pasur të deleguar nga VV-ja. E di që disa delegatë nga komuniteti joshumicë nuk ishin të pranishëm. Mbetën vetëm 5 delegatë dhe kuvendi zgjati edhe 1 orë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, unë e kisha lut Munirin, në qoftë se ju është shkelë e drejta, munden në gjykatë me e çue, unë jam e gatshme. Prej se e kam marrë unë kryesimin e Kuvendit, personi më i privilegjuar ka qenë z.Munir, prej krejt komuniteteve. Nuk kam bërë asnjë rend të ditës pa e ftue z.Munir, pa u konsultue. Le të dalë dhe le ta thotë. Me ato që i ka nda z.Sejdilar, me ato kam me u marrë tash. Se i ka këput krejta veç ato ku është dashtë me i këput. Sot gjykatat kanë me punue. Mua më së shumti janë duke më shkuar seancat duke mos ia prishur atij ose këtij tjetrit. Por, kjo është seancë. Në qoftë se ju doni me i prish, po i prishi edhe unë. Unë kam ardhë më dëshirën e juaj këtu, edhe me dëshirën e juaj dal. Kur të keni qef dhe kur të doni.

Uran Halimi: Unë po ndërlidhem te çështja e regjistrimit të seancave, se atë pjesën tjetër unë kam mungue në seancë edhe nuk e di çka ka ndodhë. Mirëpo, ne e kemi fuqinë edhe ju si kryesuese e keni që krejt këto mediat për mostransparencë me i largue prej këtu, edhe me hap një tender edhe me kandidue media që ne mendojmë që janë transparente edhe i plotësojnë kriteret. Përndryshe, unë të kisha sygjerru që këtyre mediave me ua ndalue financat që i marrin prej Kuvendit Komunal. Këtë problem e kam pas edhe unë, znj.kryesuese, vazhdimisht mas seancës më thirrshin edhe më thojshin nuk e ka publikue seancën, ose hyjke live edhe mo nuk e bojke upload për me e rujt në arkivë. Domethënë, e transmetojshin aty për aty seancën, edhe e fshijshin prej rrjeteve që mos me e pa. U duhke unë me thirrë në telefon privatisht, me i thonë bëne upload seancën se po ma lypin qytetarët. Ka pas edhe mostransmetim të seancave live, me arsyttime palidhje, jo po bllokohet e jo ku me dit çka. Mirëpo, ne paguajmë për media, nuk paguajmë për telefona, se me telefon na edhe vetë e incizojmë seancën. Edhe ju si kryesuese mundeni në llogarinë e juaj ose të Komunës sonë, që e ka ëëbfaqen Komuna, na mundim me telefonin tënd edhe në ëëbfaqe të Komunës, s'kemi nevojë për pagesë të mediave hiç. Po na paguajmë media, unë qysh e di, për me transmetue qeto seanca, qeto evente, qet punën e Kuvendit Komunal. Përndryshe neve, mas tri a katër viteve ose mas seancave, qytetarët tanë kanë të drejtë me thënë Kuvendi nuk është funksional. Qysh e argumentojmë na që jemi Kuvend funksional, kur s'ka bazë ligjore. Kështu që, kryesuese, na ke mbrapa, propozoje largimin e këtyre, ndaljai fondet, edhe ata le të vijnë e të punojnë këtu pa pare. Mirëpo, ajo media që paguhet, duhet me dhënë llogari për këtë parregullsi, se kjo është parregullsi, kjo është jotransparencë. Edhe juvë si kryesuese, edhe neve si Kuvend, na qet shumë keq. Unë të kisha propozue që me u marrë me këtë çështje, meqenëse jemi edhe ne delegatë edhe jemi pro rregullimit të këtyre parregullsive. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e mbyllim këtë Komitet!